

Konferenca Ndërkombëtare “Auditimi i financimit të partive politike dhe fushatave elektorale” organizuar nga SAI i Sllovakisë

27.11.2024

Më datë 27 nëntor 2024 u zhvillua në Bratisllavë, Konferenca Ndërkombëtare me titull “Auditimi i financimit të partive politike dhe fushatave elektorale”, si iniciativë e Zyrës Supreme të Auditimit të Republikës së Sllovakisë, në kuadër të presidencës së saj të ardhshme të Organizatës Evropiane të Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAI).




elektorale.

Konferenca ishte projektuar për një gamë të gjerë profesionistësh, duke përfshirë përfaqësues të organeve qeveritare, akademike, partive politike, organizatave jofitimprurëse dhe institucioneve të auditimit, duke nënvizuar faktin se, diferencat në kuadrin ligjor respektiv të shteteve të ndryshme, sjellin nevojën thelbësore të përafrimit të qasjes së auditimit, për financimin nga fondet publike të partive politike gjatë fushatave

Konferenca ishte e ndarë në dy blloqe tematike:

I. Blloku i parë sa i takon kuadrin legjislativ të financimit të partive politike dhe fushatave elektorale në Republikën Sllovake, duke përfshirë një prezantim edhe të situatës në Republikën Çeke.

II. Blloku i dytë sa i takon ofrimin të një perspektive ndërkombëtare ku përfaqësues të vendeve të ndryshme paraqitën përvojën e tyre në kontrollin e financimit të partive politike dhe fushatave zgjedhore, duke përfshirë auditimet dhe rezultatet e tyre. Pjesëmarrësit kishin mundësinë të krahasonin qasjet e ndryshme dhe të nxirrnin mësimë prej tyre. Konferenca synoi të ndajë informacion mbi sistemet ekzistuese të financimit të partive politike dhe fushatave elektorale, si në kontekstin e Republikës Sllovake ashtu edhe të vendeve evropiane, veçanërisht në përvojën e auditimeve të kryera dhe konkluzionet e tyre.



Nga KLSH, konferenca u ndoq në platformën youtube të mundësuar nga organizatorët nga z. Nertil Meta, auditues pranë Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qëndrore.